



THE AIRE CENTRE
Advice on Individual Rights in Europe



annual regional
**RULE OF
LAW FORUM**
for south east europe

Forumi i Dhjetë Vjetor Rajonal i Shtetit të së Drejtës për Evropën Juglindore

Balancimi i Mbrojtjes së të Dhënave me Drejtësinë
Transparente: Korniza Ligjore Evropiane

Raport



UK Government



Sweden

Sverige

Hyrje

➤ Çfarë është Forumi i Shtetit të së Drejtës për Evropën Juglindore?

Ky Forum bashkon gjyqtarë të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNJ), kryetarë dhe gjyqtarë të gjykatave supreme dhe kushtetuese të rajonit, kryetarë të këshillave gjyqësore, përfaqësues të institucioneve të kualifikimit gjyqësor, agjentë të qeverisë para Gjykatës së Strasburgut, përfaqësues të organizatave joqeveritare (OJQ), dhe ekspertë të njohur ligjorë të fushës. Organizatorët dhe pjesëmarrësit e Forumit punojnë për të promovuar implementimin e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) në tërë Evropën Juglindore, për të frymëzuar bashkëpunimin rajonal drejt fuqizimit të shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut, dhe për të ndihmuar vendet e Evropës Juglindore në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian (BE).

Forumit është rezultat i partneritetit të gjatë mes Programit të Qendrës AIRE për Ballkanin Perëndimor dhe Mbrojtësve të të Drejtave të Njeriut, dhe këtë vit Forumi kishte domethënie të veçantë meqenëse shënoi përvjetorin e tij

të dhjetë. Forumi gjithashtu i detyrohet shumë bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe jetik të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila e bën punën tonë jashtëzakonisht më të informuar dhe tërheqëse. Për fund, falënderojmë përkrahësit e Forumit dhe përkushtimin e tyre të vazhdueshëm ndaj parimeve të shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut: Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar dhe Qeveria e Suedisë.



► Forumi 2023: Balancimi i Mbrojtjes së të Dhënave me Drejtësinë Transparente

Në vitin 2023, Forumi i Dhjetë Rajonal Vjetor i Shtetit të së Drejtës u fokusua tek çështjet që po shfaqen në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale dhe drejtësinë transparente. Këto dy tema, si dhe ndërveprimi mes tyre, janë duke u bërë gjithnjë e më aktuale, ndërkohë që teknologjia vazhdon të transformojë mënyrën se si hetohen dhe ndiqen krimet, dhe mënyrat

se si zhvillohen dhe regjistrohen procedurat penale. Diskutimet ishin të përqendruara rreth mbrojtjes së Nenit 8 të KEDNJ-së, e drejta për respekt ndaj jetës private dhe familjare, në kontekstin e procedurave gjyqësore, duke pasur parasysh kriteret e të drejtës për proces të rregullt sipas Nenit 6 KEDNJ dhe të drejtën për lirinë e shprehjes sipas Nenit 10 KEDNJ.

► Folësit dhe Panelistët e Forumit

Forumit u shqua nga pjesëmarrja e anëtarëve nga institucionet më të larta gjyqësore të Evropës dhe rajonit, përfshirë Kryetaren e Gjykatës Kushtetuese të Bosnje dhe Hercegovinës, Valejia Galić. Gjyqtarët ndërkombëtarë që udhëhoqën diskutimet përfshinin:

- **Marko Bošnjak** - Nënkryetar i GjEDNJ-së
- **Arnfinn Bårdson** - Gjyqtar i GjEDNJ-së i zgjedhur në lidhje me Norvegjinë, Kryetar Seksioni
- **Jovan Ilievski** - Gjyqtar i GjEDNJ-së i zgjedhur në lidhje me Maqedoninë e Veriut
- **Darian Pavli** - Gjyqtar i GjEDNJ-së i zgjedhur në lidhje me Shqipërinë

- **Erik Wennerström** - Gjyqtar i GjEDNJ-së i zgjedhur në lidhje me Suedinë
- **Faris Vehabović** - Gjyqtar i GjEDNJ-së i zgjedhur në lidhje me Bosnje dhe Hercegovinën
- **Ivana Jelić** - Gjyqtar i GjEDNJ-së i zgjedhur në lidhje me Malin e Zi
- **Davor Derenčinović** - Gjyqtar i GjEDNJ-së i zgjedhur në lidhje me Kroacinë
- **Tim Eicke** - Gjyqtar i GjEDNJ-së i zgjedhur në lidhje me Mbretërinë e Bashkuar
- **Ledi Bianku** - ish-Gjyqtar i GjEDNJ-së dhe Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të Bosnje dhe Hercegovinës

► Udhërrëfyesi i Forumit 2023

Këtë vit Forumi u shoqërua nga një udhërrëfyes për gjyqësorin dhe ushtruesit e profesionit ligjor. Pjesa e parë e udhërrëfyesit mëton të ofrojë udhëheqje praktike rreth çështjeve të reja të të drejtave të njeriut të shfaqura kohët e fundit në lidhje me mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë e informacionit në kontekstin e procedurave gjyqësore. Ky publikim adreson në detaje praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, me fokus tek Nenet 6, 8 dhe 10 të KEDNJ-së, duke pasur parasysh njëkohësisht të drejtën e BE-së, së cilës GjEDNJ i është referuar në praktikën e saj gjyqësore. Pjesa e dytë përmban përmbledhje të praktikës gjyqësore të GjEDNJ-së dhe Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (GjDBE) e identifikuar si më relevante për të drejtat e Konventës të diskutuara në pjesën e parë.



Udhërrëfyesi përmendet si referencë përgjatë këtij raporti, dhe përmbajtjen e tij mund ta gjeni të plotë [këtu](#).

► Fjalimet në Hyrje të Forumit

Forumit u hap me fjalë përshëndetëse nga themeluesit e Forumit, **Biljana Braithwaite** dhe **Goran Miletic**. Këto fjalime përfshinin një shikim të rritjes së Forumit të Shtetit të së Drejtës gjatë dhjetë viteve dhe falënderime për shumë kontribuuesit dhe pjesëmarrësit e Forumeve të kaluara, duke mbajtur parasysh edhe karakterin e kohshëm të tematikës së Forumit në një epokë kur teknologjia dhe të dhënat janë gjithnjë e më prezente.

Fjalimet hyrëse nga **Valerija Galic**, Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Bosnje dhe Hercegovinës, **Julian Reilly**, Ambasador i Anglisë në Bosnje dhe Hercegovinë, dhe

Helena Lagerlöf, Ambasadore e Suedisë në Bosnje dhe Hercegovinë, u bazuan pikërisht mbi këtë tematikë duke zgjeruar më tej shtrirjen e çështjeve. Mes të tjerash, ata folën për mënyrat në të cilat e drejta për privatësi dhe drejtësia transparente mund të bien ndesh me njëra-tjetrën por njëkohësisht mund të jenë edhe fuqizuese për njëra-tjetrën; për mënyrën se si zhvillimet në teknologji pashmangshëm sjellin rreziqe të reja për shoqërinë, individët dhe shtetin e së drejtës; dhe për vlerat e bashkëpunimit rajonal në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës.



Teknologjia gjithnjë në zhvillim vazhdon të ofrojë mundësi dhe sfida në kontekstin e procedurave gjyqësore. Përdorimi i masave hetimore inovative, si përgjimi dhe interceptimi i komunikimeve elektronike, qartazi tregojnë se sasia e madhe e provave që gjykatat dhe prokurorët kanë përpara dhe informacionet që mund të mblidhen me metoda të tilla kanë potencialin që të galvanizojnë përpjekjet për të parandaluar dhe ndëshkuar krimin e organizuar. Megjithatë, duhen marrë hapa në pajtim me të drejtat e Konventës dhe me nevojën për të siguruar drejtësi dhe besim tek sistemi gjyqësor. Gjyqësori është qenësor në trajtimin e këtyre shqetësimeve, duke siguruar që të ketë mbrojtje të mjaftueshme dhe duke njohur njëkohësisht avantazhet domethënëse që mund të sjellin prova të tilla.

Biljana Braithwaite



Forumi ka shërbyer në vazhdimësi si burim frymëzimi dhe motivimi për të gjithë pjesëmarrësit, përfshirë mua. Impakti i tij shkon përtej thjesht shkëmbimit të ideve; ai nxit një pasion kolektiv i cili fuqizon përkushtimin tonë të përbashkët për avancimin e parimeve të drejtësisë dhe të drejtave të njeriut. Tema e këtij viti është posaçërisht jetike. Ekuilibri mes mbrojtjes së të dhënave dhe transparencës në procedurat gjyqësore është çështje me rëndësi të madhe, e rrënjosur thellë në parimet e shtetit të së drejtës dhe demokracisë. Njëkohësisht, ai ndikon së tepërmi edhe tek ruajtja e besimit të qytetarëve tek gjyqësori, çka është thelbësore në një kohë kur besimi tek demokracia dhe sistemi gjyqësor në rajonin tonë ka shënuar rënie.

Goran Miletic

➔ Fjalimi kryesor: Gjyqtari Marko Bošnjak, Zv/Kryetar i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Fjalimi kryesor nga **Gjyqtari Bošnjak** ishte një introduktë e shkëlqyer e situatave të ndryshme ku nevoja për mbrojtjen e informacionit dhe të dhënave private duhet të ekuilibrohet me kujdes me rëndësinë e drejtësisë transparente. Gjyqtari Bošnjak identifikoi dy kategori çështjesh: së pari, kur sistemi gjyqësor mbështetet tek të dhënat personale dhe i bën ato publike, dhe, së dyti, kur vetë sistemi i drejtësisë krijon të dhëna personale të cilat më pas vihen në lëvizje nga mediat.

Gjyqtari Bošnjak bëri një analizë të këtyre dy kategorive nën prizmin e katër çështjeve nga GjEDNJ. Në lidhje me kategorinë e parë, ai shqyrtoi çështjet *B. dhe P. k. Mbretërisë së Bashkuar, L.L. k. Francës dhe Vicent del Campo k. Spanjës*. Përmes këtyre çështjeve, mes të tjerash, Gjyqtari Bošnjak theksoi se si struktura

e arsyetimit të GjEDNJ-së dhe parimet kyçe të interpretimit të KEDNJ-së mbeten të njëjtat në shumë kontekste. Për shembull, qasja që ndërmerret GjEDNJ në lidhje me çështjen e proporcionalitetit të një ndërhyrjeje tek Neni 8 është plotësuuese me qasjen e Gjykatës gjatë shqyrtimit të ndërhyrjeve tek Neni 6 dhe nevojën për të balancuar Nenin 6 me të drejta dhe interesa të tjera. Në lidhje me kategorinë e dytë, Gjyqtari Bošnjak shpjegoi që çështja e Dhomës së Madhe *Hurbain k. Belgjikës* në lidhje me 'të drejtën për t'u harruar' dhe arkivat dixhitale të shtypit tregoi ekuilibrin që duhet vënë mes të drejtës për t'u informuar sipas Nenit 10 dhe të drejtës për mbrojtjen e informacioneve private sipas Nenit 8.

Gjyqtari Bošnjak gjithashtu nënvizoi se GjEDNJ vjen e dyta pas gjykatave kombëtare dhe se:



Gjyqtarët kombëtarë janë gjyqtarët e shkallës së parë në Strasburg, që do të thotë se ata ftohen të shqyrtojnë çështje të jetës së vërtetë duke përdorur instrumentet që ka zhvilluar Gjykata. Duke vepruar kështu, ata ndajnë një pjesë të rëndësishme të përgjegjësisë që gjyqtarët e Strasburgut priten të mbartin. Meqenëse po marr pjesë për herë të parë në Forumin e Shtetit të së Drejtës për Evropën Juglindore, më vjen shumë mirë teksa shoh nivelin e lartë të shkëmbimeve mes pjesëmarrësve. Natyrisht që të gjithë i pasurojnë dijet e veta me gjërat që dëgjojnë në Forum, të cilat i marrin me vete kur kthehen në shtëpi dhe i zbatojnë në jetën e përditshme. Ja kështu jeton në praktikë Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Të drejtat e garantuara nga Konventa nuk janë teorike, as iluzione, por janë praktike dhe efektive.

Marko Bošnjak

Diskutimet në panel dhe grupet e punës

➔ Diskutimi në Panelin 1: Çfarë është informacioni privat dhe të dhënat personale? Mbrojtja e informacioneve private gjatë fazës hetimore të procedurave

- **Moderator: Gjyqtari Arnfinn Bårdsen**
- **Panelistë: Gjyqtari Jovan Ilievski, Gjyqtari Darian Pavli, Gjyqtari Erik Wennerström**

Siç u diskutua nga **Gjyqtari Ilievski**, kontrolli i informacioneve personale dhe të dhënave vetjake, pra mbrojtja e të dhënave, gëzon mbrojtjen e Nenit 8 KEDNj. Kjo mund t'u aplikohet të dhënave si në domenin publik, ashtu edhe në atë privat. Gjatë grumbullimit të provave, dhe përdorimit të tyre më pas në procedura, **Gjyqtari Bårdsen** identifikoi se

ka tension mes (a) nevojës për të mbrojtur shoqërinë kundër krimeve, (b) nevojës për të mbrojtur jetën private të atyre që u nënshtrohen hetimeve, dhe (c) nevojës për të siguruar proces të rregullt. Në lidhje me vëzhgimin sekret, **Gjyqtari Pavli** foli rreth çështjeve të kohëve të fundit *Big Brother Watch k. Mbretërisë së Bashkuar dhe Centrum för rättvisa k. Suedisë*, ku Dhome e Madhe e Gjykatës shtjelloi parimet e KEDNj-së që duhen aplikuar në intercedimin e tërësishëm të të dhënave, dhe në mënyrë të veçantë rëndësinë e mbrojtjeve legjislative. Faza hetimore e procedurave gjithashtu mund të ngrejë çështje kur të dhënat e marra nga

organet publike ndahen me palë të treta: si në kontekstin vendas, ashtu edhe kur të dhënat ndahen mes shteteve. Çështjet e komunikuar së fundmi A.L. k. Francës dhe E.J. k. Francës, ku kërkuesit u ndoqën penalisht në Mbretërinë e Bashkuar mbi bazën e provave të marra përmes infiltrimit nga autoritetet franceze në softuerin e komunikimeve të koduara/enkriptuara janë veçanërisht me rëndësi për këto çështje.

Të dhënat e marra në shkelje të Nenit 8 më pas mund të përdoren në procedura gjyqësore, për shembull si prova, çka mund të angazhojë të drejtën për proces të rregullt sipas Nenit 6. **Gjyqtari Wennerström** diskutoi se pyetja qenësore sipas Nenit 6 është nëse gjyqi është i drejtë në tërësi. Kjo shpesh kthehet në pyetjen nëse ekzistojnë mbrojtje të mjaftueshme, për shembull nëse mund të kontestohen

provat dhe nëse ato janë provat e vetme. Ai theksoi se Gjykata nuk sheh lidhje automatike mes pyetjes rreth procesit të rregullt dhe pyetjes nëse ka pasur shkelje të Nenit 8 gjatë mbledhjes së provave.

Udhërrëfyesi i Forumit – për më shumë informacione në lidhje me:

- ▶ Mbrojtjet e ofruara për jetën private nga KEDNj, shih faqet 17-24, 38-42.
- ▶ Konventat 108 dhe 108+ dhe Konventa e Budapestit, shih faqet 24-27.
- ▶ Masat hetimore speciale dhe impakti i tyre tek Neni 8, shih faqet 43-59.
- ▶ Angazhimi i Nenit 6 kur provat e marra në shkelje të Nenit 8 përdoren në procedura, shih faqet 59-63.



➔ Diskutimi në Panelin Nr. 2: Publikimi i informacioneve gjatë procedurave gjyqësore; E drejta për t'u harruar

- ➔ **Moderator: Gjyqtari Marko Bošnjak**
- ➔ **Panelistë: Gjyqtari Faris Vehabović, Gjyqtarja Ivana Jelić, Gjyqtari Davor Derenčinović**

Paneli i dytë fillimisht diskutoi publikimin e informacioneve para, gjatë dhe pas procedurave gjyqësore, dhe aplikimin e Neneve 6, 8 dhe 10 në këtë kontekst.

Në këtë kontekst, e drejta për seancë publike dhe shpallje publike të vendimeve sipas Nenit 6 ka rëndësi të veçantë. **Gjyqtari Jelić** vuri në dukje që Gjykata e ka njohur interesin publik për karakterin publik të procedurave gjyqësore, megjithatë publiciteti i procedurave mund të bjerë ndesh me mbrojtjen e të dhënave personale, dhe duhet vënë një ekuilibër. Për shembull, nevoja për të mbrojtur jetën private mund të justifikojë seancat me dyer

të mbyllura në procedurat për vendbanimin e fëmijëve. **Gjyqtari Jelić** theksoi që gjykatat kombëtare duhet t'i qasen kësaj pike sipas specifikave të secilës çështje për të përcaktuar nëse përjashtimi i publikut nga disa procedura është i justifikuar. Publikimi i informacionit gjatë procedurave gjyqësore gjithashtu mund të ngrejë çështje në lidhje me prezumimin e pafajësisë. **Gjyqtari Derenčinović** diskutoi që prezumimi i pafajësisë mund të rrezikohet nga deklaratat e bëra nga zyrtarë shtetërorë, përfshirë policinë, në lidhje me gjyqin. Gjyqtarët po ashtu kanë përgjegjësinë, për shembull, që të zgjedhin fjalët dhe gjuhën që përdorin, në mënyrë që të mos shkelin prezumimin.

Publikimi i informacioneve në lidhje me procedurat gjyqësore po ashtu mund të ngrejë pyetje në lidhje me 'të drejtën për t'u harruar', e cila rrjedh nga Neni 8, që u diskutua nga **Gjyqtari Vehabović**. Duke parë përparimet në teknologji dhe në përdorimin e saj nga shoqëria, e drejta për t'u harruar ka rëndësi gjithnjë e më

të madhe për individët. Heqja e materialeve nga arkivat e shtypit në internet dhe tensionet mes Neneve 8 dhe 19 u adresuan në çështjen *Hurbain k. Blegjikës*. **Gjyqtari Vehabović** foli në lidhje me problemet potenciale të 'së drejtës për t'u harruar' nëqoftëse kjo e drejtë abuzohet, për shembull në lidhje me figurat publike, dhe përsëriti rëndësinë e faktorëve të identifikuar në çështjen *Hurbain*.

Udhërrëfyeni i Forumit – për më shumë informacione në lidhje me:

- ▶ Të drejtën për seancë publike dhe Nenin 6(1), shih faqet 71-75.
- ▶ Të drejtën për shqiptimin publik të vendimeve përfundimtare dhe Nenin 6(1), shih faqet 77-86.
- ▶ Prezumimin e pafajësisë dhe Nenin 6(2), shih faqet 65-71.
- ▶ Praktikën gjyqësore në zhvillim e sipër në lidhje me 'të drejtën për t'u harruar', shih faqet 87-112.



➔ Grupi Punues 1: Procedurat gjyqësore, privatësia dhe Neni 8 KEDNJ

→ **Moderatore: gjyqtarja Ivana Jelić**

Raportimi nga: Mirsad Ćeman, Zv/ Kryetar, Gjykata Kushtetuese e Bosnje dhe Hercegovinës; **Zorana Jadrijevic Mladar**, Agjente, Zyra e Agjentit të Serbisë në GjEDNJ.

Ky Grup Punues diskutoi standardet e Nenit 8 dhe Nenit 6 në lidhje me publicitetin e vendimeve përfundimtare të gjykatave; transparencën e gjykatave dhe prokurorive; dhe të drejtën e qytetarëve për gjyqësor të pavarur, si dhe detyrimin e gjyqësorit për të qenë i pavarur. Fokusi u vu tek anonimizimi



dhe redaktimi i vendimeve përfundimtare dhe qasjet e ndryshme që mund të ndërmerren, përfshirë anonimizimin e pjeshëm ose të plotë të vendimeve. Gjithashtu, u ngritën shqetësime

në lidhje me impaktin e anonimizimit të plotë të vendimeve në lidhje me transparencën gjyqësore dhe besimin e publikut tek gjyqësori.

➔ Grupi Punues 2: Garancitë e procesit të rregullt në procedura gjyqësore dhe Neni 6 KEDNJ

➔ **Moderator: Gjyqtari Ledi Bianku**

Raportimi nga: Tijana Badnjar, Gjyqtare, Gjykata Themelore e Podgoricës; **Milan Bajić**, Këshilltar i Lartë Ligjor për Harmonizimin e Praktikave të Gjykatës, Gjykata Supreme, Serbi

Ky Grup Punues diskutoi në lidhje me përdorimin e provave të marra përmes metodave të vëzhgimit sekret gjatë procedurave penale. Diskutimet u përqendruan tek provat e marra nga EncroChat nga autoritetet franceze, të cilat më pas iu dhanë autoriteteve të rajonit.



Një çështje që u ngrit ishte mos-zbulimi nga autoritetet franceze, për arsye të sigurisë kombëtare, të mënyrës se si ishin përfutur provat. U dhanë disa sugjerime në lidhje me

parimet që mund të zbatohen nga gjykatat kombëtare në arsyetimin e tyre kur shqyrtojnë besueshmërinë e provave.

➔ Grupi Punues 3: Diskutim mes OJQ-ve – Si mund të mbrojmë gjyqësori informacionet private pa komprometuar transparencën?

➔ **Moderator: John Stauffer, Drejtor Ligjor dhe Zv/Drejtor Ekzekutiv, Mbrojtësit e të Drejtave Civile**

Raportimi nga: Sanja Radivojevic, Këshilltare e Lartë Ligjore, Qendra për të Drejtat e Njeriut, Beograd; **Art Vula**, Koordinator i Projektit Iniciativa Rinore për të Drejtat e Njeriut (YIHR), Kosovë

Grupi Punues, i përbërë nga përfaqësues të OJQ-ve, theksoi se shpeshherë është e vështirë që publiku ose anëtarët e OJQ-ve të marrin informacione në lidhje me procedurat e shkallës së parë ose të dytë ose vendimeve përfundimtare. Gjithashtu, u tha se kishte probleme në lidhje me anonimizimin e vendimeve. Për shembull, për shkak të teknologjisë së dobët të anonimizimit, dhe

në rastet kur vendimet që kanë të bëjnë me zyrtarët publikë anonimizohen pavarësisht nga interesi publik i çështjes. Redaktimi i tepruar po ashtu mund ta pamundësojë të kuptuarit e arsytimit të vendimit.

U morën në konsideratë disa rekomandime për ndryshime, përfshirë: një sistem të qartë online për publikimin e vendimeve përfundimtare dhe informacioneve rreth procedurave; më shumë transparencë në procedurat disiplinore kundër gjyqtarëve dhe profesionistëve të tjerë ligjorë; programe të gjera trajnimi për të drejtën e mbrojtjes së të dhënave për gjyqësorin; orientime të qarta për gjyqtarët në lidhje me transparencën dhe llogaridhënien; dhe mbajtja e gjyqtarëve individualisht përgjegjës për shkeljet e ligjit për të dhënat personale gjatë procedurave.



➔ Diskutimi në Panelin Nr. 3: Duke shikuar përpara – çështjet në horizont për Strasburgun

- ➔ Moderator: Gjyqtari Ledi Bianku
- ➔ Panelistë: Gjyqtari Arnfinn Bårdsen dhe Gjyqtari Tim Eicke

Qëllimi i panelit përfundimtar ishte një shikim i tërësishëm mbibisedat dhe çështjet diskutuara gjatë Forumit, por njëkohësisht edhe një shikim përpara drejt ecurisë së mundshme të këtyre çështjeve. **Gjyqtari Bianku** e hapi diskutimin duke njohur faktin se temat e diskutuara adresojnë çështje me të cilat nuk po përballen vetëm gjykatat e rajonit por edhe gjykata nëpër Evropë dhe vetë GjEDNJ-ja. **Gjyqtari Bårdsen** theksoi se, ndërkohë që teknologjia vazhdon të përparojë me shpejtësi, ka rëndësi të merret parasysh praktika gjyqësore e mëparshme e GjEDNJ-së në lidhje me teknologjitë e reja dhe metodologjia e Gjykatës në këtë aspekt, duke iu referuar për shembull *Leander k. Suedisë, S. dhe Marper k. Mbretërisë së Bashkuar dhe Big Brother Watch k. Mbretërisë së Bashkuar*. Këto vendime tregojnë rëndësinë e mbrojtjeve kundër shkeljeve të tashme dhe të ardhme të të drejtave të njeriut që mund të sjellë teknologjia. Megjithatë, siç theksoi **Gjyqtari Bårdsen**, me zhvillimin e shpejtë të teknologjisë, përfshirë inteligjencën artificiale, gjykatat do të duhet të konsiderojnë nëse parimet e mëparshme janë të mjaftueshme. Po kështu, në lidhje me provat e marra nga masat e fshehta hetimore, posaçërisht provat e marra nga EncroChat, **Gjyqtari Eicke** diskutoi rreth rëndësisë së marrjes parasysh të praktikës së mëhershme të GjEDNJ-

së në lidhje me interceptimet e shënjestruara dhe ato të tërësishme, por njëkohësisht vuri në pyetje nëse provat nga EncroChat, të cilat mund të jenë marrë duke vendosur viruse në pajisje, mund të ngrënë çështje të tjera në këtë praktikë gjyqësore. **Gjyqtari Eicke** nënvizoi se gjykatat kombëtare luajnë rol të rëndësishëm në këto çështje, meqenëse ato kanë qasje në më shumë të dhëna sekrete sesa GjEDNJ-ja. Më tej, mund të përfitohet shumë nga shqyrtimi i qasjeve të ndërmarra nga gjykata të ndryshme kombëtare.

Paneli gjithashtu diskutoi anonimizimin dhe redaktimin e vendimeve përfundimtare. **Gjyqtari Eicke** diskutoi rreth praktikave të ndryshme të GjEDNJ-së dhe GjDBE-së në lidhje me anonimizimin. Ai theksoi se si mund të krijohen konflikte mes transparencës dhe të drejtës për qasje në informacione nga njëra anë, dhe të drejtës për respekt ndaj jetës private, e rrjedhimisht për mbrojtjen e të dhënave, nga ana tjetër. Sa i përket redaktimit të vendimeve, **Gjyqtari Eicke** vuri theksin tek rëndësia e pasjes së një mbikëqyrjeje gjyqësore, edhe nëse ajo nuk bëhet publike.

Udhërrëfyeni i Forumit – Për më shumë informacione në lidhje me:

- ➔ Komunikimet e koduara/enkriptuara të interceptuara, shih faqet 47-49, 59, 62-63.
- ➔ Anonimizimin dhe redaktimin e vendimeve, shih faqet 77-86.



Përfundime

Gjatë tërë Forumit, pjesëmarrësit nga i gjithë rajoni reflektuan së bashku me gjyqtarët e GjEDNJ-së rreth çështjeve komplekse që shfaqen në kontekstin e mbrojtjes së të dhënave dhe transparencës gjyqësore. Mes temave të ndryshme, pjesëmarrësit diskutuan për mbrojtjet e ofruara nga Neni 8 dhe Neni 6 në lidhje me masat hetimore speciale; ekuilibrin mes kriterit për proces të rregullt dhe jetës private të atyre që janë të përfshirë në procedura; dhe 'të drejtën për t'u harruar' sipas Nenit 8 dhe tensionit me të drejtën për lirinë e shprehjes sipas Nenit 10.

Këto çështje vazhdojnë të jenë gjithnjë e më shumë tematike në tërë Evropën, ndërkohë që teknologjia gjithnjë në evolucion po transformon mënyrën se si hetojmë dhe ndjekim krimet, dhe mënyrën se si zhvillojmë dhe regjistrojmë procedurat gjyqësore. U bë e qartë se këto probleme nuk janë të zakonshme vetëm në juridiksionet e pranishme në Forum por janë gjithashtu tema që po diskutohen nga të gjitha shtetet e Këshillit të Evropës, si dhe nga vetë GjEDNJ-ja. Rëndësia e ndjekjes së metodologjisë së Gjykatës u theksua shpesh, megjithatë u bë gjithashtu e qartë që krahas zhvillimit të teknologjisë do të zhvillohet edhe praktika e Gjykatës.

Një temë e qartë që doli gjatë Forumit ishte roli që luajnë gjykatat kombëtare gjatë implementimit të KEDNJ-së. Gjykatat kombëtare janë më afër provave, dhe u përsërit disa herë që gjyqtarët e Strasburgut shpesh mbështeten tek analizimi i tyre. Kjo vuri theks të shtuar tek rëndësia që ka që gjyqtarët e të gjitha shkallëve të jenë të hapur ndaj përdorimit të teknologjisë së zhvilluar dhe sfidave, por njëkohësisht edhe ndaj mundësive që kjo mund të sjellë në procedurat gjyqësore. Shpresohet se Forumi do të inkurajojë pjesëmarrësit nga tërë rajoni që të vazhdojnë të bashkëpunojnë dhe të mësojnë nga njëri-tjetri, ndërkohë që përqafojnë zhvillimet teknologjike në mënyrë të atillë që mbështet shtetin e së drejtës dhe të drejtat e njeriut.

Forumit përfundoi me një kërkesë që pjesëmarrësit të kontaktojnë Qendrën AIRE dhe Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut me çdo sugjerim që mund të kenë për përmirësimin e Forumit në vitet e ardhshme. U jemi mirënjohës të gjithë atyre që morën pjesë në Forum këtë vit, dhe shprehim falënderimet tona për të gjitha kontributet e dhëna.

➔ Lista e çështjeve të referuara:

- ▶ *A.L. k. Francës*, Nr. 44715/20; *E.J. k. Francës*, Nr. 47930/21, e komunikuar
- ▶ *B. dhe P. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 24 prillit 2001, Nr. 36337/97 dhe 35974/97
- ▶ *Big Brother Watch k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 25 majit 2021, Nr. 58170/13, 62322/14, 24960/15
- ▶ *Centrum för rättvisa k. Suedisë*, vendim i 25 majit 2021, Nr. 35252/08
- ▶ *Hurbain k. Belgjikës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 4 korrikut 2023, Nr. 57292/16
- ▶ *L.L. k. Francës*, vendimi i 10 tetorit 2006, Nr. 7508/02
- ▶ *Leander k. Suedisë*, vendimi i 26 marsit 1987, Nr. 9248/81
- ▶ *S. dhe Marper k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 4 dhjetorit 2008, Nr. 30562/04, 30566/04
- ▶ *Vicent Del Campo k. Spanjës*, vendimi i 6 nëntorit 2018, Nr. 25527/13